



Relacion
mbi
“Raportin e monitorimit të buxhetit të KQZ për periudhën
8 mujore Janar - Gusht 2023”

Mbështetur në ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", udhëzimit nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” me anë të këtij relacioni/raporti informojmë efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Misioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është të mbështesë zhvillimin e kulturës zgjedhore, të ofrojë aksesueshmëri në mënyrë të barabartë në shërbime efektive e bashkëkohore për zgjedhësit dhe palët në proces, si dhe të zhvillojë procese zgjedhore të sigurta në përputhje me standardet ndërkombëtare të besueshmërisë.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2023, objektivat e KQZ-së konsistojnë:

1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe i Kodit Zgjedhor, duke adresuar rekomandimet e bëra nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)/ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në raportet e tyre të vëzhgimit të Zgjedhjeve.
2. Përmirësimi i kapaciteteve dhe sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për të zhvilluar një proces zgjedhor të lirë dhe demokratik.
3. Rritja e transparencës në lidhje me fondet financiare të mbledhura nga partitë politike gjatë fushatave zgjedhore, përmes ndryshimeve të nevojshme ligjore.

Në zbatim të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", plani i buxhetit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u miratua në shumën 233,800,000 lekë, vetëm për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” sipas zërave:

- Shpenzime korrente 212,300,000 lekë

- Shpenzime kapitale me finncim të brendshëm 21,500,000 lekë

Gjatë vitit 2023, plani i buxhetit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pësoi këto ndryshime:

1. Në zbatim të VKM Nr.38, datë 27.01.2023 *“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023” miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*, në programin 01620 *“Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”*, në të cilin u miratuan fondet për organizimin e zgjedhjeve vendore, të datës 14 Maj 2023 konkretisht sipas zërave:
 - Shpenzime korrente 1,993,611,000 lekë
 - Shpenzime kapitale me finncim të brendshëm 606,389,000 lekë
2. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4528, datë 07.03.2023 *“Dërgohet miratimi i fondit të veçantë për vitin 2023”*, për KQZ u miratua fondi në shumën 250,000 lekë. Si rrjedhojë buxheti në dispozicion për programin *“Planifikim, menaxhim dhe administrim”* për vitin 2023 është 234,050,000 lekë.
3. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9770/1, datë 07.06.2023 *“Transferim fondesh për shpenzime kapitale”* në programin *“Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”* 01620, u shtua llogaria 230 *“studim projektim”* me shumën 49.266.240 lekë, shumë për të cilën u pakësua llogaria 231 *“investime”*
4. Në zbatim të VKM-së 325/2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.12447/1, datë 18.07.2023 *“Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023”* akordoi fondet në programin *“Planifikim, Menaxhim, Administrim”* 01610, për shpenzime personeli të cilat u shtuan për shumën 21.700.000 lekë, ndër të cilat 18.000.000 lekë për paga dhe 3.700.000 lekë për sigurime shoqërore.
5. Në zbatim të VKM-së 437, datë 19.07.2023 *“Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”*, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.13869/1, datë 31.07.2023 *“Akordim fondi për rritjen e pagave të magistratit për vitin 2023”* akordoi fondet në programin *“Planifikim, Menaxhim, Administrim”* 01610, në llogarinë 606 *“Transferta për buxhetet familjare dhe individët”* në shumën 5.500.000 lekë.

Në fund të tetëmuorit të vitit 2023, për KQZ situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të



buxhetit krahasuar me planin 2023 me ndryshime, sipas të dhënave të gjeneruara nga SIFQ, paraqitet si më poshtë:

				<i>në 000/lekë</i>
	Emërtimi	Plani I buxhetit për vitin 2023	Fakti për 8 M 2023	% e realizimit
1	Shpenzime personeli 600+601	483,781	380,057	79%
2	Shpenzime të tjera korrente 602-606	1,749,580	1,610,676	92%
3	Shpenzime Kapitale	627,889	597,292	95%
	TOTALI KQZ	2,861,250	2,588,025	90%

❖ Realizimi i shpenzimeve korrente për periudhën Janar-Gusht 2023 për KQZ siç shihet është 90% e planit për vitin 2023 ,ose 104 % e planit për 8 mujorin e parë.

Theksojmë se rreth 92 % e fondeve të akorduara për instirucionin tonë, ose 2.6 miliardë lekë janë dhe u përdorën për organizimin e zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023 si dhe për zgjedhjet e përsëritura për Kryetarin e Bashkisë Rrogoshinë të datës 23 Korrik 2023”.

❖ Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën Janar-Prill 2023 për KQZ është 95 % e planit për vitin 2023.

Realizimi i shpenzimeve 8 mujore 2023, sipas programeve paraqitet si më poshtë:

							<i>në 000/lekë</i>
kodi	Emërtimi	Plani për vitin 2023		Fakti për 8M i vitit 2023		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
01610	Planifikim, Menaxhim, Administrim	239,750	21,500	144,172	0	60%	0%
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	1,993,611	606,389	1,846,561	597,292	93%	98%
	TOTALI	2,233,361	627,889	1,990,733	597,292	89%	95%

Si dhe vihet re nga tabela e mësipërme:

1. për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim”,

- shpenzimet korrente janë realizuar 60 % e planit per vitin 2023 dhe 90 % e planit të 8 mujorit për këtë vit.
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 0 % pasi sapo kanë përfunduar procedurat e prokurimit përkatësisht sipas projekteve dhe jemi në fazën e lidhjes së kontratave.

Vlen të përmendet se këto fonde do të realizohen 100% e planit për vitin 2023.

2. për programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”,

- shpenzimet korrente janë realizuar 93 % e planit për vitin 2023 dhe 139 % e planit të 8 muhorit për këtë vit, pasi këto fonde ishin tërësisht në funksion të zgjedhjeve të 14 Majit 2023.
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 98 % Vlen të përmendet se këto fonde do të realizohen 100% e planit për vitin 2023.

Realizimi shpenzimeve të Programit “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, sipas Artikujve buxhetorë paraqitet:

Artikuj, programi 01610	Plani i rishikuar për vitin 2023	Realizimi për 8 M 2023	<i>në mijë lekë</i>
			Realizimi në %
Paga	129,300	82,905	64%
Sigurime Shoqërore	20,700	12,532	61%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	43,460	14,393	33%
Transferta Korrente të Huaja	300	0	0%
Trans per Buxh. Fam. & Individ	45,990	34,342	75%
Shpenzime Korrente	239,750	144,172	60%

Të dhënat e raportuara të buxhetit të rishikuar dhe realizimi faktik përkojnë plotësisht me të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIFQ deri në 31 Gusht 2023.

Realizimi sipas produkteve për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” është si vijon:

- **Produkti “Administratë profesionale”** është realizuar në masën 64%, përgjatë 8 muhorit kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ose 95% e planit 8 muhor 2023.
- **Produkti “Ambiente pune të mirëmbajtura”** është realizuar në masën 33%, përgjatë 8 muhorit kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ose 49% e planit 8 muhor 2023.
- **Produkti “Akte nënligjore të miratuara dhe ankime të trajtuara”** është realizuar në masën 75%, përgjatë 8 muhorit kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, ose 112% e planit 8 muhor 2023.
- **Produkti “Pajisje informatike dhe zyrash”** është realizuar në masën 0%, përgjatë 8 muhorit të parë, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, pasi sapo është lidhur

kontrata dhe është në fazën e zbatimit të kontratës.

- **Produkti "Blerje Mjete transporti"** është realizuar ne masen 0%, përgjatë 4 mujorit të parë, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, pasi po kryhen procedurat e prokurimit.

Realizimi shpenzimeve të Programit "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale", sipas Artikujve buxhetorë paraqitet:

			<i>në mijë lekë</i>
Artikuj, programi 01620	Plani i rishikuar për vitin 2023	Realizimi për 8 M 2023	Realizimi në %
Paga	318,965	271,763	85%
Sigurime Shoqërore	14,816	12,856	87%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,659,830	1,561,942	94%
Shpenzime Korrente	1,993,611	1,846,561	93%

Realizimi sipas produkteve për programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale" është si vijon:

- **Produkti "Përgatitje infrastrukture zgjedhore"** është realizuar ne masën 93 %, përgjatë 8 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023, pasi këtu përfshihen pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme si dhe pagesat lidhur me komisionerët e dhe anëtarët e qëndarve të votimit në të gjithë vendin, pagesa të cilat u kryhen pas përfundimit të procesit zgjedhor të 14 majit 2023.
- **Produkti " Proces zgjedhor i realizuar"** është realizuar ne masen 98.4%, përgjatë 8 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2023.

Realizimi i investimeve në këtë program 01620 në mënyrë të detajuar sipas projekteve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

			<i>ne mije leke</i>
Kodi projektit	Emertimi i projektit	Plani i buxhetit I RISHIKUAR 2023	REALIZIMI për periudhën e raportimit (8 -muajore)
		606,389	597,292
22AF901	Transportuese paletash elektrike Forklift	4,000	-
22AF702	Server Terciar per backup	980	-
22AF902	Restaurim i magazines nr.4 (magazina e paisjeve PEI)	2,230	-
22AF701	Infrastruktura TIK Qendrore KQZ	66,971	65,084
22AF801	Blerje pajisje (hardware) për 352 Qendra Votimi, për te cilat kërkohet te blihen 740 makina PEVN. Ne ketë sasi janë parashikuar 2	479,094	479,094
22AF801	Blerje pajisje (hardware) për 352 Qendra Votimi, 740 makina PEVN. [Liçensa per software per 760 PEVN dhe permiresimi i	49,266	49,266
22AF703	Modem për transmetimin e te dhënave	3,848	3,848

Paraqitja e informacionit si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit janë në përputhje me përcaktimet të bëra në Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe anekseve të përcaktuara në këtë udhëzim, bashkëlidhur.

Aurel LAMÇE - **DEMP “Planifikim, Menaxhim, Administrim”**

Majlinda ÇELMETA - **DEMP “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”**

Enkeleon TOPULLI - **Nëpunës Zbatues**

Ylli MERKAJ - **Nëpunës Autorizues/Sekretar i Përgjithshëm**



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PASQYRA PERMBLEDHESE E STRUKTURES SE SHPENZIMEVE BUXHETORE PER ZGJEDHJET VENDORE TË VITIT 2023

Nr.	PËRSHKRIMI	Shuma
	total	2,600,000,000
I	PAGAT	333,780,720
1	Pagat personelit te perkohshem ne KQZ	88,717,627
2	Sigurime shoq/shendetesore per personelin e perkohshem	14,815,844
3	Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, trajnuesve te KZAZ,KQV,GNV [600]	230,247,250
II	MALLRA	419,959,847
1	Materiale specifike	301,177,285
2	Materiale (shtypshkrime)	35,016,200
3	Materiale per administraten zgjedhore	26,897,300
4	Materiale (kancelari)	16,065,182
5	Materiale promocionale	6,188,000
6	Prodhim spote promocionale, TV, Radio etj	10,810,000
7	Materiale te tjera (karburant)	3,540,000
8	Materiale elektrike per kamerat ne QV	13,312,630
9	Materiale të ndryshme	5,761,500
10	Shpenzime pritje percjellje	880,000
11	Materiale pastrimi (Procesi i asgjesimit te fleteve te votimit)	311,750
III	SHERBIME	1,239,870,366
1	Sherbime të ndryshme	89,504,600
2	Sherbime të teknologjisë së informacionit	893,673,428
3	Sherbime qeramarrje	34,180,800
4	Sherbime transporti	29,882,038
5	Sherbime udhëtim e dieta	14,734,500
6	Shërbime për mediat elektronike dhe të shkruara (edukim, informim, sensibilizim)	86,950,000
7	Shperblimi i operatoreve për përdorimin e paisjeve të teknologjisë në QV	90,945,000
IV	INVESTIME	606,389,067
1	Transportuese paletash elektrike	4,000,000
2	Pajsje informatike	533,188,000
3	Pajsje Orendi në magazinat e KQZ-së	2,230,000
4	Infrastruktura TIK Qendrore KQZ (Kujdes Investim bashkepunim me projektin Zviceran)	66,971,067
	TOTALI	2,600,000,000